

# Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**BULETINI MUJOR**

**Prill 2021**



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË



Mbi takimin me ambasadorin Del Monaco, Z.Metani postoi në llogarinë zyrtare në Twitter:

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRET AMBASADORIN E OSBE-SË DEL MONACO

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani priti në takim (më 21.04.2021) kreun e prezencës së OSBE në Shqipëri, Ambasadorin Vincenzo del Monaco.

Z.Metani e uroi ambasadorin del Monaco për detyrën në vendin tonë dhe vlerësoi rolin mbështetës të prezencës së OSBE-së, në rrugëtimin e Shqipërisë për forcimin e institucioneve, vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë e njohu ambasadorin e prezencës së OSBE-së me punën e bërë nga zyra e ILD-së në këto 14 muaj, sfidat dhe rezultatet në procesin e verifikimit dhe hetimit disiplinor të magistratëve, si një detyrim edhe publik për një drejtësi me praktikat dhe standardet më të mira perëndimore.

Ambasadori i prezencës së OSBE-së në Shqipëri, vlerësoi punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shprehu gatishmërinë për të mbështetur zyrën e ILD-së në ushtrimin sa më efikas të funksioneve kushtetuese.

*Inspektori i Lartë dhe Ambasadori del Monaco bashkëndanë vullnetin për të vijuar bashkëpunimin ndërinstinucional, në funksion të mbështetjes së veprimtarisë së ILD-së, përmes fuqizimit të kapaciteteve të saj.*

“I kënaqur që takova sot Ambasadorin Vincenzo del Monaco, kreun e ri të Prezencës së OSBE në Shqipëri. OSBE ka qenë gjithmonë një aktor rëndësishëm në forcimin e shtetit të së drejtës në vendin tonë. Me Ambasadorin biseduam mbi mundësitë e bashkëpunimit mes dy institucioneve”.



## KOMUNIKIMI ME QYTETARËT

Në kuadër të zhvillimit profesional dhe standardizimit të procedurave të punës së Sektorit të Ankesave, në fillim të muajit Prill, stafi i ILD organizoi një diskutim mbi Komunikimin me qytetarët. Gjatë diskutimeve u nënvizua rëndësia që ka për institucionin trajtimi me seriozitet i çdo ankuesi dhe ofrimi i asistencës për secilin prej tyre në plotësimin e ankesës kur ata



paraqiten në ambientet e ILD. Po ashtu, në zbatim të transparencës dhe të së drejtës për informim, punonjësit e sektorit ofrojnë asistencë nëpërmjet numrit të telefonit të vënë në dispozicion për këtë qëllim, duke synuar ofrimin e garancisë për ritjen e besueshmërisë së publikut në sistemin e drejtësisë e njëkohësisht paraqitjen sa më pozitive të institucionit para qytetarëve, institucioneve të tjera, partnerëve etj, duke shmangur çdo përcëptim negativ.

***“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie. ”***

### SEKTORI I ANKESAVE

Sektor i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

### STATISTIKA

Gjatë muajit **Prill**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 125 ankesa të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione.


*Konkretisht:*

**110 ankesa** janë depozituar nga qytetarët;

**15 ankesa** kanë ardhur nga institucione publike dhe jopublike.

**33 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre. **14 takime** me ankues, të cilët janë asistuar gjatë plotësimit të formularëve të ankesave në ambientet e ILD.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Prill 2021.



Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si; shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projekt-vendimet përkatëse.

## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË NIS BASHKËPUNIMIN ME MISIONIN OPDAT TË SHBA



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe misioni OPDAT, i Departamentit të Drejtësisë në SHBA, mbajtën (më 22.04.2021) një tryezë të rrumbullakët virtuale mbi procesin e hetimit disiplinor mbi akuzat për sjellje të papërshtatshme të gjyqtarëve

e prokurorëve në Shqipëri.



Në fjalën hyrëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani, falenderoi këshilltaren ligjore rezidente të OPDAT në Shqipëri, znj. Michelle Lakomy dhe shprehu kënaqësinë për nisjen e bashkëpunimit me misionin OPDAT për forcimin e kapaciteteve të ILD-së, në drejtim të praktikave më të mira të hetimit disiplinor ndaj magjistratëve, e në funksion të misionit për kthimin e besimit të publikut tek drejtësia.



***“I lumtur nga nisja e bashkëpunimit me misionin #OPDAT për forcimin e kapaciteteve të ILD-së. Sot: vlerësimi i sjelljes së papërshtatshme të magjistratëve, me një këndvështrim nga Zyra e Përgjegjësisë Profesionale të Departamentit të Drejtësisë së SHBA. ”.***

Inspektorët dhe ndihmës-inspektorët e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë diskutuar me avokaten Leslie Ann Gerardo, e Zyrës së Përgjegjësisë Profesionale të Departamentit të Drejtësisë në SHBA, mbi raste dhe praktika të hetimit disiplinor, në funksion të përmirësimit të procesit të pranimit, shqyrtimit dhe veprimit, bazuar në akuzat për sjellje të papërshtatshme nga magjistratët, që ushtrojnë detyrën në institucionet e reja të drejtësisë, të krijuara si rezultat i reformës në drejtësi.

Ky është i pari i një serie eventesh, që OPDAT do organizojë në bashkëpunim me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si pjesë e një programi të posaçëm trajnimi dhe asistence teknike për ILD-në.





## TRAJNIM MBI HETIMIN DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATËVE

Mbi trajnimin në bashkëpunim me Euralius V, Z. Metani postoi në llogarinë e tij në Twitter:

Po ndodh: [#ILD](#) dhe [#EURALIUS](#) V, trajnim mbi hetimin disiplinor ndaj magjistratëve. Puna para fillimit të një hetimi disiplinor, interpretime të ligjit dhe zbatim i dispozitave kushtetuese gjatë tranzicionit.

Dita e dytë e trajnimit mbi praktikën e punës para fillimit të një hetimi disiplinor. Konsolidimi i praktikave të reja për të garantuar paanshmërinë në hetim, si në respekt të interesit publik, ashtu edhe të pavarësisë së magjistratëve.

**#EURALIUS #ILD**



Misioni EURALIUS V në bashkëpunim me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilloi ciklin e tretë të trajnimit mbi hetimin disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, në datat 16 dhe 17 Prill.


Gjatë trajnimit dy ditor me inspektorët, ndihmës inspektorët dhe kabinetin e ILD-së, u trajtuan specifika të punës përgatitore përpara fillimit të një hetimi

disiplinor, interpretime të ligjit, sjellja e magjistratit, si dhe zbatimi i dispozitave kushtetuese gjatë periudhës tranzitore për shkak të vakuimit ligjor.

Ky cikël trajnimesh është pjesë e trajnimeve të programuara nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në bashkëpunim me misionin EURALIUS V, në drejtim të forcimit të kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit të ILD.



## PUNA E ZYRËS SË ARKIV-PROTOKOLLIT



Zyra e arkiv-protokollit është sektori ku nis rrugëtimin çdo ankesë apo shkresë, që mbërrin pranë zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Kjo zyrë bën evidentimin e dokumenteve përmes protokollimit të




korrespondencës, që hyn apo del në ILD, si dhe dërgimin e korrespondencës së firmosur.

Ekipi i vogël por energjik i kësaj zyre realizon përpilimin, shypjen, shumëfishimin e dokumenteve dhe shpërndarjen e dokumentacionit sipas siglimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e më tej ndjek me evidencë dorëzimin e praktikave të dokumentave të mbyllura

nga sektorët përkatës në institucion.

Zyra e arkiv-protokollit kryen skanimin e çdo dokumenti që hyn ose del nga ILD, redaktimin gjuhësor të dokumenteve që krijohen nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si dhe bën klasifikimin e dokumenteve, duke u mbështetur tek ligji i arkivave nr. 9154, date 6.11.2003. Pjesë e detyrave të zyrës së arkiv-protokollit është edhe bashkëpunimi me zyrën e raportimit dhe ankesave të ILD-së, për përgatitjen e raporteve mbi numrin e ankesave të hyra në institucion, ecurinë e tyre, si dhe për çdo raport statistikor që kërkohet për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.



## Digjitalizimi

Zyra e arkiv - protokollit është e para që po përdor sistemin elektronik të menaxhimit të ankesave dhe dokumenteve, një sistem inteligjent i ndërtuar nga misioni EURALIUS, në bashkëpunim me prezencën e OSBE-së në Shqipëri, në funksion të rritjes së efikasitetit e punës së gjithë stafit të ILD-së,


Ngritja e këtij sistemi inteligjent sjell një sërë lehtësish, si përdorimi i të dhënave në kohë reale, gjenerim i informacionit të saktë, me anë të metodologjisë digjitale dhe “paperless”, duke krijuar akses të lehtë për përdoruesit e këtij sistemi.



Prill 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë



© ILD



## KONTAKT ILD

WEB: [ild.al](http://ild.al)  
EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)  
ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13  
Tiranë, Shqipëri



 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD\\_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)  [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%AB%20sis%C3%AB)



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com/spot)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)



This project is funded by the European Union

  
**EURALIUS**  
Consolidation of the  
Justice System in Albania

'Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian'